

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil,

Gjyqtari Ahmet Idrizaj, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit M.M. , nga fshati B. , Komuna e D. , të cilin e përfaqëson Q. F. avokat në D. , kundër të paditurës .. S. i a. SH.A. Gj. të cilin e përfaqëson i autorizuari F.T. , me autorizim valid në shkresat e lëndës, për kompensimin në emër të pagave përcjellëse për pension, vlera e kontestit 1,968.00 €, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 06.03.2018, në prezencë të autorizuarve të palëve në procedurë, me datë 30.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT miratohet kërkesëpadia e precizuar e paditësit M.M. nga fshati B. , Komuna e D. , ashtu që **DETYROHET** e paditura .. S. i a. SH.A. Gj. , që në emër të tri pagave përcjellëse për në pension të ia paguajë shumën totale prej 684,00€ si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 160,00€ e gjitha këto në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

KËRKESËPADIA e paditësit M. M. , nga fshati B. , Komuna e D. , me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura N.P.L. S.i a. SH.A. Gj. , që të ia kompensojë edhe pjesën tjetër të mbetur të kërkesëpadiës në lartësinë prej 1,284.00€, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit **REFUZOHET** si e pathemeltë.

A r s y e t i m

Paditësi në padinë e tij të parashtruar në gjykatë, kundër këtu të paditurës dhe nëpërmes të autorizuarit të tij, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, ka potencuar faktin se : te i padituri kishte themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, që nga data 08.05.1981 dhe ishte i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës : para punëtori i kontrollës. Gjatë kohëzgjatjes së punës, e deri te shkuarja e tij në pension të parakohshëm, paditësi ka punuar pa shkëputje nga puna te e paditura. Sipas marrëveshjes së përgjithshme kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/18. Qershor 2014), është paraparë pagesa e 3 pagave mujore, në pagesën përcjellëse sipas nenit 53 të marrëveshjes së lartciturar. Paditësit këto paga, akoma nuk i janë paguar. I padituri paditësit i ka mbetur borxh edhe 5 paga, dhe atë për muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator dhe Tetor të vitit 2001, në shumën mujore nga 246,00€, përkatësisht në shumën e përgjithshme 1,230.00€. Andaj, konsiderojë se : e paditura duhet të ia paguajë paditësit shumën e precizuar të kërkesëpadiës në lartësinë e përgjithshme prej 1,968.00€.

I autorizuari i paditësit, në fjalën e tij përfundimtare deklarojë se : i referohem normës juridike : aktori in cubi onus probandi çka do të thotë, se barra e provave i takon palës paditëse. Pala paditëse, ka qenë e detyruar, që provat materiale në këtë çështje të i sigurojë te e paditura, veçse deri më tani, kjo e fundit ka hezitur dhe gjykatës nuk ja ka sjellë provat e nevojshme. Sa i përket, 5 pagave të papaguara paditësi pa reshtur deri në pensionimin e tij ka kërkuar pagesën e tyre. I autorizuari i palës së paditur, në seancën e fundit është thirrë në vjetërsimin vjetërsues (parashkrimi shues), mirëpo meqë paditësi pa ndërprerë i ka kërkuar këto paga, mendojë se nuk kemi të bëjmë me parashkrimin shues. Megjithatë kjo çështje i lihet në kompetencë kësaj gjykate, meqë e njëjta është dominits litis – për pagesën e tillë. Ani pse marrëveshja e përgjithshme kolektive e Kosovës, nuk ishte në fuqi viteve të mëhershme, megjithatë pagesa e çdo page mujore duhej bërë më së largu deri me datën 5 të muajit në vijim, për muajin paraprak. Sipas marrëveshjes së sipër cekur të datës 18.03.2014, neni 53 i saj, i punësuari ka të drejtë të i realizon 3 paga përcjellëse për pension, ngase kjo çështje sipas marrëveshjes kolektive është “Jus cogens” që e paditura doemos është dashur, t’a respektojë këtë dispozitë. C ‘është e vërteta i autorizuari i palës së paditur, thirret në Rregulloren e marrëdhënies së punës nr. 167, shtrohet pyetja : ku është ekzemplari i kësaj rregulloreje? I padituri është thirrur në Ligjin e Punës 03 – L-212, që sipas tij, nuk u lejohej pagesa e 3 pagave përcjellëse, mirëpo marrëveshja e cekur më sipër, e dt. 18.03.2014

e detyron Ndërmarrjen për pagesën e 3 pagave. Pra, këtu duhet t'i referohemi parimit me Lex Specialis – Derogat Lex Generalis, me këtë deshta të them se : pas arritjes së marrëveshjes kolektive, ishte dashur doemos që të bëhet pagesa e këtyre pagave. Andaj, nga kjo gjykatë e nderuar, kërkojë që t'a miratojë në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të paditësit, si të themeltë.

Shpenzimet i kërkojë sipas listës së shpenzimeve.

I autorizuari i të paditurit, në përgjigje në padi të parashtruar me datë 01.02.2017 dhe gjatë shqyrtimeve të kësaj çështjeje juridiko – civile, ka parashtruar se : e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, meqë e njëjta është e pathemeltë. Këtë nga fakti se : pretendimi i paditësit, që të i kompensohen 3 paga përcjellëse me rastin e pensionimit, nuk parashihen me dispozitat e Ligjit të Punës, ndërsa pretendimi i paditësit, që të njëjtit të i kompensohen edhe 5 paga, për muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator dhe Tetor të vitit 2001, në shumën mujore nga 246,00€, përkatësisht në shumën e përgjithshme 1,230.00€ është një pretendim i cili sipas dispozitave ligjore, është i parashkruar.

I autorizuari i të paditurit në fjalën e tij përfundimtare deklarojë se : të gjitha kërkesat e paditësit që janë më të vjetra se 3 vjet, duhen të refuzohen në bazë të dispozitave ligjore, po ashtu duhen të refuzohen të gjitha kërkesat e paditësit të parashtruara para kohe, si dhe i mbetet gjykatës të e vlerësojë afatin e kontratës kolektive, zbatueshmërinë e saj, si dhe të i refuzojë të gjitha kërkesat të cilat bazohen në kontratën kolektive e cila nga pala paditëse u tha që është e vitit 2014 ndërsa dihet se kontrata kolektive e ka afatin 3 vjeçar. Rregullorja e cila u përmend nga pala paditëse, ndërmarrja me rastin e pensionimit, punëtorëve iu jep si shpërblim një shumë simbolike monetare në bazë të mundësive të saja financiare mirëpo jo si obligim, kur dihet se në ndërmarrje kemi probleme për të iu siguruar pagat e punëtorëve. Andaj, gjykatës i propozojë që kërkesëpadia e precizuar e paditësit të refuzohet në tërësi si e pathemeltë dhe shpenzimet të i bartë paditësi sipas dispozitave ligjore.

Shpenzimet i kërkojë sipas dispozitave ligjore.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve juridike – relevante të kësaj çështjeje, zbatimit me ndërgjegje të provave materiale të administruara në rastin konkret, si dhe duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e precizuar e palës aktive në procedurë, është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë, pjesërisht u miratua.

Nga provat e zbatuara, u argumentua gjendja faktike si në vijim:

Gjykata vërtetojë se : në mes të palëve në procedurë, ishte rrethanë jokontestues fakti se : këtu e paditura për të gjithë punëtorët e saj të punësuar, duke filluar nga viti 2012 – 2017, i ka paguar të gjitha kontributet obliguese, përfshirë këtu edhe kontributet për paditësin (dhe për këtë i autorizuari i të paditurit i posedonte edhe provat relevante nga ATK mirëpo, të njëjtat nuk u zbatuan në cilësi të provës, meqë ishte jokontestues në mes të palëve vërtetësia dhe validiteti i tyre, rreth faktit se kontributet e gjithë punëtorëve, përfshirë edhe paditësin, e paditura i ka paguar me rregull për periudhën e lartcitur).

Nga vërtetimi i këtu të paditurës i datës 05.03.2018, është konstatuar se : paga mujore bruto e paditësit, deri në muajin qershor të vitit 2015 ka qenë 324,00€, ndërsa i njëjti me kërkesën e tij dhe sipas vendimit të të paditurës, për pensionim të parakohshëm, i është kompensuar 70% vlera e pagës dhe është paguar në lartësinë prej 227,00€ bruto në muaj deri në pensionimin e rregullt. Së bashku me pagën i janë paguar edhe kontributet pensionale dhe tatimi në burim në pagë.

Gjykata duke pasur parasysh rrethanat jokontestuese në mes të palëve, faktit se paditësit i janë paguar të gjitha kontributet në paga duke llogaritur edhe ato të pensionit të parakohshëm rezulton se : kërkesëpadia e tij, e precizuar është e themeltë vetëm në lartësinë prej 684,00€ nga fakti se paga e tij neto e të njëjtit ka qenë 227,00€ ndërsa 3 paga jubilarë në këtë lartësi përbëjnë shumën e aprovuar të lartësisë prej 684,00€, shumë kjo e cila paditësit në rastin konkret i takon sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në Kosovë, e publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”, nr. 38/2014, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015. Neni 3 i marrëveshjes së lartcitur, ka paraparë se kjo marrëveshje është e detyrueshme – obligatore në territorin e

Republikës së Kosovës. Neni 4 par. 1, i marrëveshjes së lartcituara në mënyrë decisive ka paraparë se : “Dispozitat e MPKK-së, i obligojnë punëdhënësit të cilët në çfarëdo mënyrë kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të degës dhe të ndërmarrjes. Paragrafi 2 i nenit të paracituar, parasheh se : “Degët e sindikatave të veprimtarive jo ekonomike (shërbimet civile, publike dhe ndërmarrjet publike), lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre (ministritë përkatëse, atë të administratës publike, arsimit, shëndetësisë etj.), në pajtim me specifikat e tyre. Neni 53 i marrëveshjes së sipërcituar parasheh : “I punësuarit me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3), muajt e fundit”. Andaj, nga këto rezultojnë se pala pasive në procedurë më asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk argumentojë faktin se këtu paditësit të ia ketë paguar 3 pagesa përcjellëse të cilat i takojnë me rastin e pensionimit, e që është obligim ligjor i saj, për çka u vendos në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa shuma e kontributeve për tre (3) muajt e fundit, ishte paguar nga ana e palës pasive në procedurë, rrethanë kjo jokontestuese në mes të palëve dhe atë shuma nga 19,00€ në muaj, për 3 muaj, i bie shuma prej 57,00 € andaj, kjo shumë nuk iu pranua paditësit, meqë po të veprohej ndryshe, do të vinte deri te pasurimi i pabazë i paditësit në dëm të të paditurit, e që një pagesë e këtillë do të binte ndesh edhe me nenin 194 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës /nr.16/19 Qershor 2012, (i cili është në implementim nga data 20.12.2012).

Gjykata vërtetoi se pretendimi i të autorizuarit të të paditurës në raport me vlerën prej 1,230.00€ (për pagat e papaguara të paditësit për muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator dhe Tetor të vitit 2001), lidhur me parashkrimin e kërkesës qëndron këtë nga fakti se paditësi padinë lëndore e ka parashtruar në vitin 2016, ndërsa kërkesën për pagat e papaguara, për muajt e lartcituara, të vitit 2001, i ka ushtruar pas afatit të paraparë ligjor, andaj edhe kërkesa e tillë sipas dispozitës së nenit 371 të LMD-së, publikuar në “Gazetën Zyrtare të RSFJ” nr. 29, me datë 26.05.1978 (i cili Ligj është aplikuar në vitin 2001), është parashkruar. Edhe dispozita e LMD-së të ri, sipas nenit 352 parasheh afatin e përgjithshëm të parashkrimit për pesë (5) vjet.

Pretendimi i palës pasive në procedurë, se kinse e njëjta ka probleme financiare për të siguruar pagat e punëtorëve, për këtë procedurë gjykata i konsideron si jo me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes.

Gjykata administrojë edhe prova të tjera në këtë çështje, mirëpo meqë të njëjtat nuk kishin fare influencë për të vendosur ndryshe në rastin konkret, nuk e bëri analizimin e tyre veç e veç.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 2 të LPK-së dhe **suksesit në kontest**, ashtu që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale, iu pranua shuma e përgjithshme prej 160,00€, e cila i referohej përpilimit të padisë, taksës gjyqësore për padi dhe pjesëmarrjes të autorizuarit të tij në 3 seanca (2 seanca = 100% dhe 1 seancë = 50%).

Nga të lartë cituara u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.711/2017 të datës 30.05.2018

GJYQTARI,
Ahmet Idrizaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.